



Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 10.03.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin mars 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të saj.